

**AUTORITETI PORTUAL DURRES**

**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>FAQE</b>
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	<b>6</b>
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	<b>7</b>
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	<b>8</b>
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	<b>9</b>
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	<b>10 – 48</b>

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Për Menaxhimin dhe aksionarin e vetëm të Autoriteti Portual Durrës

#### Opinion me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Autoritetit Portual Durrës (Shoqëria ose APD) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinionin me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

#### Baza për Opinionin me rezervë

Sikurse është parashikuar në shënimin 14 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020, në zërin aktive të tjera afatgjata është paraqitur Huadhënia në valutë ndaj PIU-të për investime në terminale në shumën prej 120,298,752 lek (31 dhjetor 2019: 118,421,819 lek) e cila është e mbartur prej disa vitesh. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësimin e kësaj llogarie, Shoqëria nuk ka kryer zhvlerësimin e kësaj llogarie sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Si rrjedhojë nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjen e llogarisë së Huadhënie në valutë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Sikurse është paraqitur në shënimin 8 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020 gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare është në vlerën 470,001,379. Shoqëria ka kryer një çmuarje për zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme në përputhje me analizën e përshkruar në shënimin 8 dhe ka regjistruar zhvlerësimin në vlerën 144,014,723. Metodologjia e përdorur nuk përfshin ndonjë analizë mbështetëse për të justifikuar masën e përqindjeve të përdorura për provigjionimin e llogarive të arkëtueshme, siç kërkohet në përputhje me kërkesat e SNRF 9 "Instrumentet Financiarë" i cili kërkon vlerësim individual ose kolektiv për balancat e arkëtueshme bazuar në analizë të plotë mbështetur mbi të dhëna historike.

Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjet e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020.

Sikurse është paraqitur në shënimin 10 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020, inventari paraqitet në vlerën 552,367,041 lek (31 dhjetor 2019: 559,650,864 lek), prej të cilës një pjesë e konsiderueshme është me qarkullim të ngadaltë dhe është krijuar për më shumë se 1 vit. Sipas SNK 2 Inventari duhet të njihet për vlerën me të vogël ndërmjet kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive që një pjesë e inventarit është i vjetërsuar apo i dëmtuar, Shoqëria nuk ka bërë vlerësimin e vlerës neto të realizueshme të inventarit. Si rrjedhojë nuk jemi në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për vlerën e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Sikurse është paraqitur në shënimin nr 12 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2020, aktivet afatgjata materiale të Shoqërisë janë paraqitur me vlerën kontabël neto në shumën 11,375,236,747 lek (31 dhjetor 2019: 10,492,737,324 lek). Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 36 "Zhvlerësimi i aktiveve", njësia ekonomike duhet të kryejë një vlerësim të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndonjë indikacion për ndonjë rënie vlere nga zhvlerësimi. Nëse identifikohen raste të tilla, njësia ekonomike kërkohet të bëjë një vlerësim të shumës së rikuperueshme të aktiveve të saj. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, Shoqëria nuk ka kryer një vlerësim të shumës së rikuperueshme të aktiveve të saj afatgjata, d.m.th një provë për zhvlerësim, sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Bazuar në informacionin që kemi marrë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që ndonjë rregullim i mundshëm që vjen nga zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale do të ketë në pasqyrat financiare të shoqërisë. Shuma e zhvlerësimit deri në masën e vlerës së rikuperueshme të tij do të ulë proporcionalisht aktivet dhe kapitalin e pronarit.

Shoqëria përdor modelin e rivlerësimit për kategorinë toka, dhe ka kryer rivlerësimin e fundit në vitin 2008. Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, nëse shoqëria përdor modelin e rivlerësimit për një kategori të aktiveve afatgjata është e nevojshme që rivlerësimi të përsëritet të paktën pas 3-5 vite. Si rrjedhojë, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt të mundshëm që mund të rezultonte nga rivlerësimi i tokave në pronësi.

Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues 21 "Detyrime të tjera" të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2020, gjendja për llogarinë "Garanci e mbajtur për huanë e IDA dhe BERZH" pasqyrohet respektivisht në vlerën 312,870,089 lek (31 dhjetor 2019: 311,707,101 lek). Ne nuk na janë vënë në dispozicion dokumenta justifikues të duhur dhe të mjaftueshëm për gjendjen e llogarisë "Garanci e mbajtur për huanë IDA dhe BERZH" më 31 dhjetor 2020. Ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me ekzistencën dhe plotësinë e gjendjes së detyrimeve të tjera. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues nr. 23 të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2020, gjendja e granteve qeveritare të Shoqërisë është 1,161,463,590 lek (31 dhjetor 2019: 412,165,744 lek). Ne nuk na janë vënë në dispozicion dokumenta justifikues të duhur dhe të mjaftueshëm për gjendjen e granteve qeveritare të krijuara në periudhat e mëparshme. Ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me ekzistencën dhe plotësinë e gjendjes së granteve qeveritare. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Gjate vitit 2020 Shoqëria ka marrë në dorëzim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë disa asete me vlerë 847,309,897 lek, asete të cilat janë dorëzuar nga koncesionari “Durrës Container Terminal” si pasojë e prishjes së kontratës së koncesionit. Sipas kërkesave të Standartit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 20, këto asete të marra në dorëzim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk përmbushin kushtet e parashikuara në standard për t'u klasifikuar si grante. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Sikurse është pasqyruar në shënimin shpjegues nr. 20 të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2020, huatë paraqiten në vlerën 3,339,635,236 lek (31 dhjetor 2019: 3,714,496,233 lek) prej të cilave vlera prej 1,211,788,269 lek (31 dhjetor 2019: 1,325,045,680 lek) paraqet huanë nga IDA, vlera 1,880,239,998 lek (31 dhjetor 2019: 1,984,851,008 lek) paraqet huanë nga BEI dhe vlera 240,449,408 lek (31 dhjetor 2019: 394,496,411 lek) paraqet huanë nga BERZH. Gjithshtu Shoqëria ka regjistruar interesin e përllogaritur prej 7,157,561 lek (31 dhjetor 2019: 10,103,134 lek).

Si pjesë e procedurave të auditimit, ne dërguam letra konfirmimi direkt tek huadhënësit dhe deri në datën e përgatitjes së këtij raporti nuk morëm konfirmime nga BEI dhe IDA ose dokumenta rakordimi ndermjet palëve. Rrjedhimisht, ne nuk jemi në gjendje të konfirmonim apo verifikonim me metoda alternative në mënyrë që të fitonim siguri të arsyeshme për plotësinë dhe saktësinë e huasë përmendur më lart më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Shoqëria nuk ka kryer njohjen me vlerë të drejtë në ditën e parë të marrjes së huave si dhe nuk ka aplikuar me pas metodën e kostos së amortizuar mbi huatë e marra siç kërkohet në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9. Si rrjedhojë, ne nuk mund të përcaktojmë nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm në lidhje me detyrimet e huave dhe elementet që përbëjnë pasqyrën e fitimit apo humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### **Theksim çështje**

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 5 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

## mazars

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



15 qershor 2021

**Diana Ylli (Golemi)**

Auditues Ligjor

**Autoriteti Portual Durrës**

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>AKTIVE</b>			
<b>Aktivët afatshkurtra</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre	6	1,142,700,223	1,311,170,872
Llogari të arkëtueshme neto	8	470,001,379	444,864,319
Aktive te tjera afatshkurtra	9	526,077,026	472,816,614
Investime financiare	7	1,026,446,310	1,012,252,103
Tatim i parapaguar mbi fitimin	17	-	26,409,421
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	11	23,059,692	25,116,093
Inventari (neto)	10	552,367,041	559,650,864
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>3,740,651,671</b>	<b>3,852,280,286</b>
<b>Aktivët afatgjata</b>			
Aktivët afatgjata materiale	12	11,375,236,747	10,492,737,324
Aktivët afatgjata jomateriale	13	137,095,095	173,679,115
Aktive te tjera afatgjata	14	120,298,752	118,421,819
Huadhenie afatgjate	14	50,000,000	-
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>11,682,630,594</b>	<b>10,784,838,258</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>15,423,282,265</b>	<b>14,637,118,544</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme	15	100,749,960	63,235,834
Detyrime te tjera	16	63,138,960	67,561,728
Detyrime afatshkurtër të huave që mbartin interesa	20	500,411,270	520,417,148
Tatimi mbi fitimin	17	28,747,746	-
Detyrime tatimore	18	25,157,392	14,682,742
Provizione	19	111,719,565	112,785,545
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>829,924,893</b>	<b>778,682,997</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Grante qeveritare te shtyra	23	1,161,463,590	412,165,744
Hua që mbartin interesa	20	2,839,223,966	3,194,079,085
Detyrime te tjera	21	312,870,089	311,707,101
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>4,313,557,645</b>	<b>3,917,951,930</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>5,143,482,538</b>	<b>4,696,634,927</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksioner		5,470,000,000	5,470,000,000
Rezerva ligjore		331,716,751	319,463,730
Rezerva të tjera		4,059,232,648	3,824,484,085
Fitimet e pashperndara		81,475,403	81,475,403
Fitimi i ushtrimit		337,374,925	245,060,399
<b>Totali i kapitalit</b>	22	<b>10,279,799,727</b>	<b>9,940,483,617</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>15,423,282,265</b>	<b>14,637,118,544</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 10 – 48, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u përgatitën nga drejtuesit e Shoqërisë më 31.03.2021.

**Z. Pirro Vengu**  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



**Z. Donjet Zeneli**  
Përgjegjës i Sektorit të Kontabilitetit

**Autoriteti Portual Durrës***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga shërbimet	24	2,258,567,756	1,795,130,120
Të ardhura të tjera	25	159,429,813	44,880,422
<b>Total të ardhura</b>		<b>2,417,997,569</b>	<b>1,840,010,542</b>
Furnizime dhe shërbime	26	(423,499,175)	(268,966,201)
Shpenzime personeli	27	(717,207,726)	(601,516,347)
Amortizimi dhe zhvleresimi i aktiveve aftgjate	12,13	(567,318,969)	(527,555,116)
Shpenzime të tjera operative	28	(134,711,039)	(112,394,632)
Shpenzime zhvlerësimi dhe provizioni	29	(131,015,254)	(16,698,814)
<b>Total shpenzime</b>		<b>(1,973,752,163)</b>	<b>(1,527,131,110)</b>
<b>Fitim operativ</b>			
Te ardhura (shpenzime) interesi (neto)	30	(28,658,442)	(34,007,580)
Fitime ( humbje) nga kursi i kembimit (neto)	31	15,870,823	14,361,282
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>431,457,787</b>	<b>293,233,134</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(94,082,862)</b>	<b>(48,172,735)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	32	(94,082,862)	(48,172,735)
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>337,374,925</b>	<b>245,060,399</b>
Pjesa e të ardhurave gjithpërfshirëse nga pjesmarrjet		14,194,206	12,252,103
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>14,194,206</b>	<b>12,252,103</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>351,569,131</b>	<b>257,312,502</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 10 – 48 , të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Autoriteti Portual Durrës***(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 01 janar 2019</b>	<b>5,470,000,000</b>	<b>302,445,821</b>	<b>3,505,899,624</b>		<b>340,368,176</b>	<b>9,618,713,621</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	245,060,399	245,060,399
Transferim në fitime të mbartura	-	-	306,332,358	-	(306,332,358)	-
Transferim në rezerva ligjore	-	17,017,909	-	-	(17,017,909)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	-	(17,017,909)	(17,017,909)
Rregullim i detyrimit tatimor	-	-	-	81,475,403	-	81,475,403
Ndryshim i kuotave të fondit të investimit	-	-	-	12,252,103	-	12,252,103
Transferime në rezerva	-	-	12,252,103	(12,252,103)	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>5,470,000,000</b>	<b>319,463,730</b>	<b>3,824,484,085</b>	<b>81,475,403</b>	<b>245,060,399</b>	<b>9,940,483,617</b>
Fitimi i vitit	-	-	-	-	337,374,925	337,374,925
Transferim në fitime të mbartura	-	-	220,554,357	-	(220,554,357)	-
Transferim në rezerva ligjore	-	12,253,021	-	-	(12,253,021)	-
Dividendë të shpërndarë	-	-	-	-	(12,253,021)	(12,253,021)
Ndryshim i kuotave të fondit të investimit	-	-	-	14,194,206	-	14,194,206
Transferime në rezerva	-	-	14,194,206	(14,194,206)	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020</b>	<b>5,470,000,000</b>	<b>331,716,751</b>	<b>4,059,232,648</b>	<b>81,475,403</b>	<b>337,374,925</b>	<b>10,279,799,727</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 10 – 48 , të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Autoriteti Portual Durrës**
*(Vlerat janë në Lek)*
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
<b><i>Aktivitetet operative</i></b>		
Fitimi para tatimit	431,457,787	293,233,134
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Amortizimi i aktiveve afatgjata	567,318,969	527,613,064
Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital	(6,690,764)	56,451,907
Te ardhura nga grantet	(123,460,722)	(29,281,814)
Provizjon per ceshtje gjyqesore	6,546,786	16,698,814
Rimarrje provizioni	(7,612,766)	(31,141,576)
Zhvleresime	123,397,829	-
Te ardhura nga interesi	(3,344,844)	(7,187,205)
Shpenzime interesi	28,658,442	42,025,507
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues:</i>		
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme	(149,605,529)	(12,998,654)
Rënie/(rritje) në aktivet e tjera dhe taksa per tu marre	(23,135,191)	(90,499,811)
Rënie/(rritje) në inventar	7,283,823	(249,788)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme	(17,643,041)	(8,154,304)
Rritje/(rënie) në detyrime të tjera	22,546,608	4,054,333
<b>Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>855,717,387</b>	<b>760,563,607</b>
Interes I paguar	(34,948,859)	(42,922,339)
Interes I arketuar	1,685,445	27,698,134
Tatim fitimi I paguar	(38,925,695)	(98,118,934)
	<b>(72,189,109)</b>	<b>(113,343,139)</b>
<b><i>Aktivitetet investuese</i></b>		
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(560,040,006)	(325,395,350)
Investime në të tjera njësi	-	(1,000,000,000)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues</b>	<b>(560,040,006)</b>	<b>(1,325,395,350)</b>
<b><i>Aktivitetet financuese</i></b>		
(Ripagim)/të hyra neto nga huatë afatgjata	(368,570,580)	(417,530,193)
(Ripagim)/të hyra neto detyrime të tjera financiare	1,162,988	-
Huadhënie	(50,000,000)	-
Rimarrje/shtesë grante qeveritare të shtyra	25,448,671	-
Dividendë të paguar	-	(17,017,910)
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>	<b>(391,958,921)</b>	<b>(434,548,103)</b>
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	(168,470,649)	(1,112,722,985)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	1,311,170,872	2,423,893,857
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>1,142,700,223</b>	<b>1,311,170,872</b>

6

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 10 – 48 , të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

*(Vlerat janë në Lek)***1. Informacion i përgjithshëm**

AUTORITETI PORTUAL DURRËS (“Shoqëria” ose “APD”) u themelua si një Shoqëri aksionere dhe u regjistrua më 4 dhjetor 1998, bazuar në vendimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të datës 13 nëntor 1998 dhe mbështetur në ligjin nr. 7296 datë 20 prill 1995, Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare<sup>1</sup>. Përpara datës së themelimit, Shoqëria ishte një ndërmarrje shtetërore.

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr 596 datë 10 shtator 2004 dhe ligjit nr 9130 datë 8 shtator 2003, Për Autoritetin Portual<sup>1</sup>, Shoqëria ndyshoi statusin e saj nga shoqëri aksionere në person juridik publik siç përcaktohet në ligjin, Për shoqëritë tregtare<sup>1</sup>. Ky transformim ligjor u bë me qëllim që të përmirësonte efikasitetin dhe përfitueshmërinë e portit me anë të një drejtimi të pavarur nga ana tregtare.

Deri në 30 Qershor 2006 aksioneri i Shoqërisë ishte Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Shqipërisë („METE“). Që nga kjo date e deri me 11 Shtator 2013 aksioneri i Shoqërisë ishte Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit. Që nga data 11 Shtator 2013 e deri tani aksioneri i Shoqërisë është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë .

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve portuale ndaj palëve të treta, si ngarkim dhe shkarkim i anijeve e mallrave, ankorim i trageteve e anijeve dhe magazinim i mallrave të ndryshëm.

Gjatë vitit 2013, sektori Energjetik, si dhe Sektori i Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës Inxhinjrike dhe Informatike, kanë kaluar në shërbim privat me kontrata disa vjeçare. Aktualisht kontratat në fuqi janë si më poshtë:

- Kontrata me Nr.1933 Prot., dt. 31.05.2019 për kalimin e shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës energjitike dhe asaj elektrike, operatorëve privat me bashkimin e operatorëve Alba-Elettrica dhe HTM me kohëzgjatje 4 vjet.
- Kontrata me numër reference 20 PH 2017 për “Mirëmbajtjen e sistemeve të Teknologjisë, Informacionit dhe Komunikimit operatorëve privat”, me operatorin “Tetra Solution” Sh.p.k, me kohëzgjatje 5 vjet.

Në 31 dhjetor 2020 Autoriteti Portual Durrës kishte të punësuar një total prej 556 punonjës (2019: 461 punonjës). Zyrat e Shoqërisë janë në Durrës, Shqipëri.

Ligji “Për Autoritetin Portual” merr parasysh riorganizimin e APD në administrator të portit, në të cilin Autoriteti Portual siguron dhe drejton sipërfaqen e portit (tokën dhe ujin) dhe infrastrukturën bazë (vendet e ankorimit), ndërsa të gjitha operacionet e portit dhe shërbimet e lidhura sigurohen nga sektori privat, subjekt të konçesioneve dhe liçensave të rregulluara nga ligji “Për Autoritetin Portual” dhe nga ligji “Për konçesionet”.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, përgjatë vitit 2013 ka dhënë me kontratë konçesioni disa nga shërbimet dhe pasuritë e Autoriteti Portual Durrës si më poshtë:

Objekti	Emri i Operatorit	Data	Afati	Shënim
Terminali i Konteniereve	Durres Container Terminal	07.02.2013	35 vjet	Anulluar
Terminali i Mallrave Rifuxho	EMS Shipping & Trading GmbH	15.07.2013	35 vjet	Vazhdon
Terminali i Trageteve	Albanian Ferry Terminal Operator Shpk	11.09.2013	25 vjet	Vazhdon

*(Vlerat janë në Lek)*

## **1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)**

### **Terminali i kontenierëve**

Në bazë të kontratës konçesionare me Durrës Container Terminal ('DCT') merr në dorëzim Terminalin e kontenierëve në Portin e Durresit.

Në bazë të kontratës konçesionare për terminalin e kontenierëve DCT merr në dorëzim objektet e aseteve të infrastrukturës, objektet e aseteve energjitike, burimet njerezore, ngarkesat në terminalin e kontenierëve, mjetet dhe mekanizmat për qëllime të përdorimit dhe destinacionin e përcaktuar në marrëveshjen konçesionare, të cilat do të menaxhohen, operohen dhe përmisohen tërësisht nga DCT. Kalata jepet në përdorim të Shoqërisë Konçesionare për zbatimin e marrëveshjes konçesionare, dhe kryerjen e operacioneve në terminal. APD do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e kalatës si dhe mbledhjen direkt të të ardhurave të kalatës. DCT do të rikthejë për Autoritetin Portual të gjitha asetet e marra në dorëzim sipas marrëveshjes konçesionare dhe legjislacionit në fuqi duke përfshirë të gjithë përmisimet teknike të bëra në keto asete. Çdo investim për infrastrukture dhe punime të tilla si instalime fikse dhe riparime apo përmisime të ngjashme të kryera nga DCT gjatë gjithë kohës janë ose do të mbeten nën pronësinë e Autoritetit të Portit të Durresit. DCT duhet të investojë në Terminalin e Kontenierëve një shumë prej 1,267,549,812 Lekë për 10 vite nga data e kontratës.

Në vitin 2017 Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ngriti një padi kundër DCT me objekt "Zgjidhjen e kontratës për dhenien me konçesion të menaxhimit, operimit, mirëmbajtjes dhe përmirësimit teknik të terminalit të kontenierëve në portin e Durresit", padi e cila u pranua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe u vendos zgjidhja e kontratës. Në shkurt 2019 edhe Gjykata Administrative e Apelit u shpreh duke lënë në fuqi vendimin për zgjidhjen e kontratës. Vendimi për zgjidhjen e kontratës konçesionare u ekzekutua në 03.02.2020 duke kaluar në dorëzim terminalin nga DCT tek APD dhe që nga kjo datë deri në 31.12.2020 operacionet në terminalin e kontenierëve janë kryer nga APD

### **Terminali i Mallrave Rifuxho**

Në bazë të kontratës konçesionare me EMS Shipping and Trading GmbH ("EMS") merr në dorëzim Terminalin e mallrave rifuxho në Portin e Durresit.

Në bazë të kontratës konçesionare për terminalin e mallrave rifuxho EMS -së i jepet e drejta për menaxhimin, operimin, ndertimin, mirëmbajtjen, përmisimin teknik dhe adaptimin për të përmbushur kërkesat aktuale dhe të ardhshme të trafikut në Terminalin Lindor Durres. Vlera që EMS do të investojë në këtë konçesion është 2,069,371,737 Lek.

Në bazë të kontratës konçesionare për terminalin e mallrave EMS do të paguajë për Autoritetin Portual pagesën në masën 11 % të gjitha tarifave të aplikuara, si dhe pagesën pagesën e Tarifës së qirasë në masën 544 lek/m<sup>2</sup> për zonën konçesionare.

### **Terminali i Trageteve**

Në bazë të kontratës konçesionare me Albanian Ferry Terminal Operator Shpk ("AFTO") merr në dorëzim terminalin e trageteve në Portin e Durresit.

Në bazë të kontratës konçesionare për terminalin e trageteve AFTO do të marrë në dorëzim objektet e aseteve të infrastrukturës, objektet e aseteve energjitike, burimet njerezore, kontratat në proces të terminalit të trageteve 'Kontrat operacionale, të qirasë; dhe të shërbimeve të mirëmbajtjes së aseteve', burimet njerezore dhe sistemet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për qëllime të përdorimit dhe destinacionin e përcaktuar në marrëveshjen konçesionare, të cilat do të menaxhohen, operohen dhe përmisohen tërësisht nga AFTO.

*(Vlerat janë në Lek)*

## **1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)**

### **Terminali i Trageteve (vazhdim)**

Në bazë të kontratës konçesione për terminalin e mallrave AFTO do të paguajë për Autoritetin Portual pagesën në masën 49 % të gjitha tarifave të aplikuara, si dhe pagesën pagesën e Tarifës së qirasë në masën 544 lek/m<sup>2</sup> për zonën konçesionare. Vlera që AFTO do të investojë në këtë Konçesion është 4,143,000 Euro.

Investime për infrastrukture, punime civile, mjete dhe makineri, të tilla si ndertime instalime zyra, ndërtim vend-punime, rrjete inxhinierike për energjinë, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, instalime të inxhinierise civile, instalime shtylla ndriçimi, garth rrethues, porta dyer, kanalizime e tubacione dhe cdo investim tjetër përfshire dhe përmisime të kryera nga AFTO gjatë gjithë kohës janë ose do të mbeten nën pronësinë e Autoritetit të Portit të Durrësit.

AFTO do të rikthejë për Autoritetin Portual të gjitha asetet e marra në dorezim sipas marreveshjes konçesionare dhe legjislacionit në fuqi duke përfshirë të gjithë përmisimet teknike të bëra në keto asete.

## **2. Bazat e përgatitjes**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe në përputhje me dhe ligjin Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” në Shqipëri.

### **2.2. Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.

*(Vlerat janë në Lek)*

## **2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**

### **2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)**

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

#### **2.5.3. Zhvlerësimi i inventarëve**

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

*(Vlerat janë në Lek)*

### **3. Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara**

#### **3.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Disa deklarata kontabël të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2020 dhe për këtë arsye janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatin financiar ose pozicionin e njësisë ekonomike.

- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)
- Ndryshimet në Referencat e Kuadrit Konceptual (Standarde të Ndryshme)
- Konçensione të lidhura me qira në kushtet e COVID-19 (Ndryshime në SNRF 16)

#### **3.2. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale**

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo efektive, ndryshime në Standardet ekzistuese dhe Interpretime janë publikuar nga BSNK.

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kuadrin Konceptual
- Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata me kushte rënduese - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtra ose afatgjata (ndryshime në SNK 1)

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga njësia ekonomike. Menaxhimi parashikon që të gjitha deklaratimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë duke filluar nga ose pas datës efektive të shpalljes. Standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet e pa miratuara në vitin aktual nuk janë përfshirë në shënimet shpjeguese pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

### **4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### **4.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/Lek	123.70	121.77
USD/ Lek	100.84	108.64
SDR/lek	145.24	150.23

##### 4.2. Instrumenta financiare

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Instrumentat financiare – njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes.** Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivitetit.

**Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit.** Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH. Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

(Vlerat janë në Lek)

#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

**Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare** – kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

**Aktivet financiare** – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

**Aktivet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësisive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

##### *Investime në letra me vlerë*

Investimet në letra me vlerë janë instrumente borxhi për të cilat Shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë që ti mbaje deri në maturim dhe ti klasifikojë si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat mbahen deri në maturim maten në vijim me koston e amortizuar minus provigjionin përzhvlerësim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo zbritje ose prim në blerje.

##### *Instrumente kapitali*

Instrumentet e kapitalit janë aktive financiare të cilat nuk kanë një çmim tregu në një treg aktiv dhe vlera e drejte e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme prandaj maten me kosto.

##### *Depozita me afat*

Depozitat me afat janë klasifikuar si kredi dhe të drejta dhe mbahen me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi.

(Vlerat janë në Lek)

#### 4. Politikat Kontabël (vazhdim)

##### 4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

###### *Llogarite te arketueshme*

Llogarite e arketueshme nga aktiviteti krzesor dhe te arketueshme te tjera paraqiten me koston e amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi

###### *Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë vlerat në arkë, llogari rrjedhëse në Banka, të tjera investime afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to, mbahen me koston e amortizuar.

***Detyrimet financiare – kategorite e matjes.*** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

***Detyrimet financiare – çregjistrimi.*** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

***Kompensimi i instrumenteve financiare.*** Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë.

Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

###### ***Detyrimet financiare***

Shoqëria i klasifikon detyrimet financiare në kategoritë vijuese: llogari të pagueshme dhe huamarrje.

###### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

###### *Huamarrja*

Huamarrja njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huatë më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Huatë klasifikohen si detyrime afatshkurtra, me përjashtim në rast se eniteti ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)**

###### *Kostot e huamarrjes*

Kostot e huamarrjes të cilat lehtësisht janë të lidhura me ndërtimin, prodhimin apo blerjen e një aktivi, i cili ka nevojë për një kohë të gjatë për tu vënë në përdorim sipas qëllimit fillestar të përdorimit apo shitjes, i shtohen vlerës së aktivit, deri në momentin në të cilin aktivi është gati për përdorim. Të ardhurat nga investimet që fitohen gjatë një aktivi përkatës, i zbritet koston së kapitalizueshme të huamarrjes. Të gjitha kostot e tjera të huamarrjes njihen në pasqyrën e te ardhurave gjithëpërfshirëse.

###### *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përlllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

##### **4.3. Inventari**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën FIFO (dalja e parë hyrja e parë).

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

##### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

###### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.4. Aktive afatgjata materiale**

###### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe ko stoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

###### *iii. Amortizimi*

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivitetit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në bazë të vlerës së mbetur, duke përdorur normat e përcaktuara nga manxhimi. Vlera e mbartur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen për zhvlerësim kur ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, kur vlera kontabël tejkalon vlerën e rikuperueshme të vlerësuar aktivitetit paraqiten me vlerën e tyre të rikuperueshme, e cila është më e larta mes vlerës së tyre të drejtë minus kostot për shitje dhe vlerës së tyre në përdorim.

Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Ndërtesat, kalatat, sheshet dhe automekanizmat amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me normën 5%. Makineritë dhe pajisjet amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me 20%.

Pajisjet e zyrës amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me normën 20% dhe pajisjet informatike amortizohen sipas metodës së vlerës së mbetur me 25%.

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e nevojshme.

###### *iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

##### **4.5. Aktivet afatgjata jo-materiale**

Aktivitet afatgjata jo-materiale, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet e akumuluar. Norma e amortizimit është 15% bazuar në koston e aktivitetit.

###### *Shpenzimet e mëpasshme*

Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga Shoqëria apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

###### *Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të patrupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivitetit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë bilanci. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën e gjithëpërfshirëse të të ardhurave.

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.6. Të ardhurat**

Të ardhurat përfaqësojnë hyrjen e përfitimeve ekonomike bruto përgjatë rrjedhjes normale të biznesit, kur këto hyrje rezultojnë në rritje të kapitalit, ndryshe nga rritjet që vijnë si kontribute të aksionereve. Të ardhurat përfaqësojnë vlerën e drejtë të hyrjeve apo të llogarive të arketueshme nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, në rrjedhën normale të biznesit. Të ardhurat paraqiten neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kthimet apo skontot pasi janë eliminuar shitjet brenda Shoqërisë, nese ka. Të ardhurat nga shërbimet njihen në kohën që shërbimi ofrohet

. Të ardhurat klasifikohen në bazë të terminaleve: terminali i mallrave gjenerale, terminali i mallrave rifuzo, terminali i kontenierëve, terminali i trageteve dhe administrata. Të ardhurat nga shërbimet njihen ne periudhen kontabile që shërbimi ofrohet duke i'u referuar fazës së realizimit të transaksionit, bazuar në vlerësimin e shërbimit të realizuar aktualisht në lidhje me totalin e shërbimit që do të ofrohet. E ardhura nga qiraja e ambjenteve të dhena me qira njihet në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë kohës së qirasë. Pagesat e motivimit të dhëna, njihen si pjesë përbërëse e të ardhurave totale nga qiraja gjatë kohës së qirasë.

##### **4.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

##### **4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare, interesin e arkëtueshëm nga fondet e investuara dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

##### **4.9. Shpërndarja e dividendit**

Shpërndarja e dividendit aksionerëve të Shoqërisë njihet si detyrim në periudhën në të cilën dividendët janë aprovuar nga aksionerët e Shoqërisë.

Sipas kushtëzimeve që ka nga kontrata e huasë me BERZH, APD zbaton një politikë dividendësh, në bazë të së cilës mban minimalisht 80% të fitimeve neto për çdo vit fiskal.

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.10. Grantet qeveritare**

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur duke pakësuar shpenzimet e amortizimit të periudhës në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

##### **4.11. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

##### **4.12. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Shoqëria nuk operon me ndonjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas pensioni.

##### **4.13. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

*(Vlerat janë në Lek)*

#### **4. Politikat Kontabël (vazhdim)**

##### **4.14. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij.

Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

##### **4.15. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

##### **4.16. Krahasueshmëria e informacionit kontabël**

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën pozicionit financiar si edhe në pasqyrën të fitim humbjes.

#### **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit**

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

##### *Tatimi mbi fitimin*

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatimit fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

*(Vlerat janë në Lek)*

## **5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)**

### *Jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale*

Siç është përshkruar në shënimin 4.4 Drejtimi i Shoqërisë ka rishikuar dhe vlerësuar jetën e dobishme të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportuese. Gjatë vitit aktual, Drejtimi ka vendosur që jeta e dobishme për aktive afatgjata materiale nuk ka ndryshuar.

### *Vlerësimi i modelit të biznesit*

Modeli i biznesit orienton klasifikimin e aktiveve financiare. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjes, Kompania konsideron frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsyet për shitjet dhe pritjet për aktivitetin e shitjeve të ardhshme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kredisë mund të jetë në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale. Shitjet e tjera para maturimit, jo të lidhura me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit objektivi i të cilit është që të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukse monetare kontraktuale, me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në tërësi.

Kompania vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes që nga fillimi i aktivitetit të saj të shitjes. Modeli i biznesit "mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur" nënkupton që mjetet janë mbajtur për të mbledhur flukset e mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu pjesë integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një kthimi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes së aseteve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë këto asete.

### *Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa principali dhe interesit ("VPPI")*

Përcaktimi nëse flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa principali dhe interesi kërkon gjykim.

Të arkëtueshmet tregtare të Kompanisë përfshijnë një fluks të vetëm të parasë, pagesën e shumës që rezulton nga një transaksion në fushën e zbatimit të SNRF 15, që konsiderohet të jetë principali. Rrjedhimisht, flukset monetare që rrjedhin nga të arkëtueshmet plotësojnë testin VPPI të pagesave të principalit dhe interesit pavarësisht se përbërësi i interesit është zero.

### *Matjet humbjeve të parashikuara të kredisë*

Niveli i humbjeve nga zhvlerësimi llogaritet për llogaritë e arkëtueshme të matura me koston e amortizuar. Meqenëse të arkëtueshmet tregtare nuk përmbajnë një komponent të rëndësishëm financimi, niveli i humbjeve do të llogaritet bazuar në humbjet e pritshme të kreditit. SNRF 9 lejon përdorimin e një matricë provizionesh në të cilën llogariten kostot e zhvlerësimit për llogaritë e arkëtueshme të vjetra ose të vonuara.

### *Inventarët*

Inventarët maten me shumën më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme. Në përcaktimin e vlerës neto të realizueshme. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit minus koston e përlllogaritura për përfundimin dhe realizimin e shitjes. Shoqëria merr parasysh evidencat dhe/apo të dhenat më objektive që mund të ketë në dispozicion.

*(Vlerat janë në Lek)*

**5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit (vazhdim)**

*Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë*

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në Shoqëri. Ndërsa masat kufizuese kanë filluar të lehtësohen, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare individuale, Shoqëria po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***6. Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre**

Balanca e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>Llogari rrjedhëse</b>	<b>438,618,897</b>	<b>692,569,404</b>
Në Lekë	207,492,835	238,988,428
Në valutë	231,126,062	453,580,976
<b>Depozita</b>	<b>704,081,326</b>	<b>618,601,468</b>
<b>Mjete monetare në arkë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
	<u><b>1,142,700,223</b></u>	<u><b>1,311,170,872</b></u>

Depozitat me afat maturimi një vjeçar dhe llogaritë rrjedhëse ndodhen në Banka të ndryshme që operojnë në Shqipëri, në degët e tyre lokale në Durrës të cilat analizohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Banka Kombetare Tregtare („BKT“) Albania	58,067,939	50,153,193
Credins Banka Albania	588,715,639	587,700,440
Union Bank Albania	9,586,525	14,225,255
Procredit Bank Albania	118,000,601	28,515,601
Intesa Sanpaolo Bank Albania	31,921,500	106,158,542
American Bank of Investment (“ABI”) Albania	37,258,991	247,744,613
Alpha Bank Albania	65,982,475	100,143,206
United Bank of Albania (“UBA”) Albania	123,740,330	42,530
Tirana Bank Albania	16,199,887	1,621,431
First Investment Bank Albania	19,331,750	14,250,721
Raiffeisen Bank (“RZB”) Albania	51,082,508	153,282,073
Societe General Albania	22,812,078	7,333,267
	<u><b>1,142,700,223</b></u>	<u><b>1,311,170,872</b></u>

**7. Investime financiare**

Në gusht 2019 Autoriteti Portual Durrës vendosi të investojë një pjesë të mjeteve monetare (1,000,000,000 lekë) që kishte nëpër banka në fondin e investimit Credins Premium. Detajet në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i kuotave	789,409.10	789,409.10
Cmimi per kuote (leke)	1,300.27	1,282.29
	<u><b>1,026,446,310</b></u>	<u><b>1,012,252,103</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***8. Llogari të arkëtueshme neto**

Balanca e llogarive të arkëtueshme të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të arkëtueshme nga shërbimi për tragetet	97,274,929	109,857,457
Llogari të arkëtueshme nga shërbimi konteniere	88,230,822	34,328,653
Llogari të arkëtueshme nga shërbimi mallrave rifuzo	38,352,568	41,075,787
Llog. të arkëtueshme nga shërbimi mallrave generale	354,331,605	266,373,694
Llogari të arkëtueshme nga administrata	25,705,861	21,819,625
Llogari të arkëtueshme te tjera	10,120,317	114,850,559
Zhvlërimi i llogarive të arkëtueshme	(144,014,723)	(143,441,456)
	<u><b>470,001,379</b></u>	<u><b>444,864,319</b></u>

Lëvizjet në zhvlërimin e të drejtave për arkëtim paraqiten me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendje më 1 janar	143,441,456	143,441,456
Rimarrje zhvlërimi (mbyllje klientesh)	(105,474,171)	-
Zhvlërim për vitin	106,047,438	-
Gjendje më 31 dhjetor	<u><b>144,014,723</b></u>	<u><b>143,441,456</b></u>

Struktura e moshës së llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është si vijon:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Deri në 30 ditë	132,450,823	110,353,328
Nga 1 deri në 3 muaj	21,953,737	38,196,107
Nga 3 deri në 6 muaj	28,301,961	22,613,138
Nga 6 deri në 12 muaj	81,524,980	15,511,125
Mbi 1 vit	349,784,602	401,632,077
<b>Llogari të arkëtueshme bruto</b>	<u><b>614,016,103</b></u>	<u><b>588,305,775</b></u>
Provizion për zhvlërim të llogarive të dyshimta	(144,014,723)	(143,441,456)
<b>Llogari të arkëtueshme, neto</b>	<u><b>470,001,379</b></u>	<u><b>444,864,319</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës**

**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(Vlerat janë në Lek)*

**8. Llogari të arkëtueshme neto (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2020 cilësia e llogarive të arkëtueshme të Shoqërisë mund të analizohet si më poshtë:

	<b>Jo me vonesë Jo të zhvlerësuara</b>	<b>Me vonesë Jo të zhvlerësuara</b>	<b>Me vonesë dhe të zhvlerësuara</b>	<b>Totali</b>
Llogari të arkëtueshme (kosto)	132,450,823	337,550,556	144,014,723	614,016,102
Provizione për zhvlerësime	-	-	(144,014,723)	(144,014,723)
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>132,450,823</b>	<b>337,550,556</b>	<b>-</b>	<b>470,001,379</b>

Më 31 Dhjetor 2019 cilësia e llogarive të arkëtueshme të Shoqërisë mund të analizohet si më poshtë:

	<b>Jo me vonesë Jo të zhvlerësuara</b>	<b>Me vonesë Jo të zhvlerësuara</b>	<b>Me vonesë dhe të zhvlerësuara</b>	<b>Totali</b>
Llogari të arkëtueshme (kosto)	110,353,328	334,510,991	143,441,456	588,305,775
Provizione për zhvlerësime	-	-	(143,441,456)	(143,441,456)
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>110,353,328</b>	<b>334,510,991</b>	<b>-</b>	<b>444,864,319</b>

**9. Aktive të tjera afatshkurtra**

Balanca e aktiveve të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
TVSH për tu arkëtuar	500,761,045	402,698,925
Të arkëtueshme të tjera nga tatimet	27,040,250	27,040,250
Debitorë të tjerë	25,863,899	64,085,628
Provizione për debitorë të tjerë	(34,979,054)	(21,008,189)
Të arkëtueshme nga donatorë për grante	4,847,682	-
Interes i përlllogaritur	2,543,204	-
	<b>526,077,026</b>	<b>472,816,614</b>

**10. Inventari (neto)**

Balanca e inventarit më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
Pjesë këmbimi	518,652,269	527,390,846
Inventarë të tjerë	59,217,637	55,592,257
Zhvlerësimi inventarit	(25,502,865)	(23,332,239)
	<b>552,367,041</b>	<b>559,650,864</b>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***10. Inventari (neto) (vazhdim)**

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendja më 1 janar	23,332,239	23,222,289
Rimarje inventari i nxjerrë jashtë përdorimit	-	109,950
Zhvlerësimi i ngarkuar për vitin	3,379,527	-
Inventar I nxjerre jashtë përdorimi	(1,208,901)	-
Gjendja më 31 dhjetor	<u><b>25,502,865</b></u>	<u><b>23,332,239</b></u>

**11. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Balanca e shpenzimeve të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të shtyra	23,059,692	25,116,093
	<u><b>23,059,692</b></u>	<u><b>25,116,093</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës**

**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(Vlerat janë në Lek)*

**12. Aktivet afatgjata materiale**

Balanca e llogarive aktiveve afatgjata materiale të shoqërisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<b>Toka, troje dhe terrene</b>	<b>Ndërtesa</b>	<b>Kalata dhe sheshe</b>	<b>Makineri dhe Pajisje</b>	<b>Makineri dhe pajisje</b>	<b>Pajisje zyre dhe</b>	<b>Asete në proçes</b>	<b>Totali</b>
<b>Kosto</b>								
Gjendja më 1 janar 2019	1,567,449,475	2,976,676,259	9,307,824,793	2,013,918,786	777,147,059	276,813,854	140,172,868	17,060,003,094
Shtesa	-	20,548,290	812,264	1,000,000	10,961,127	5,467,494	305,136,395	343,925,570
Transferime	-	(98,552,352)	-	-	-	-	(21,703,079)	(120,255,431)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,567,449,475</b>	<b>2,898,672,197</b>	<b>9,308,637,057</b>	<b>2,014,918,786</b>	<b>788,108,186</b>	<b>282,281,348</b>	<b>423,606,184</b>	<b>17,283,673,233</b>
Shtesa	-	6,873,873	3,191,040	768,476,891	97,630,205	18,446,918	552,440,808	1,447,059,735
Pakësime	-	-	(1,070,638)	(25,636,039)	-	(4,047,909)	(6,690,764)	(37,445,350)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,567,449,475</b>	<b>2,905,546,070</b>	<b>9,310,757,459</b>	<b>2,757,759,638</b>	<b>885,738,391</b>	<b>296,680,357</b>	<b>969,356,228</b>	<b>18,693,287,618</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>								
Gjendja më 1 janar 2019	-	1,123,774,773	3,285,511,251	1,144,988,819	537,376,650	223,497,818	-	6,315,149,311
Amortizimi i vitit	-	92,924,843	301,125,098	63,402,386	48,891,095	11,543,620	-	517,887,042
Kthim amortizimi	-	(42,100,444)	-	-	-	-	-	(42,100,444)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>1,174,599,172</b>	<b>3,586,636,349</b>	<b>1,208,391,205</b>	<b>586,267,745</b>	<b>235,041,438</b>	<b>-</b>	<b>6,790,935,909</b>
Amortizimi i vitit	-	86,375,498	286,222,112	117,419,411	54,826,011	11,955,878	-	556,798,910
Kthim amortizimi	-	-	-	(25,636,039)	-	(4,047,909)	-	(29,683,948)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>1,260,974,670</b>	<b>3,872,858,461</b>	<b>1,300,174,577</b>	<b>641,093,756</b>	<b>242,949,407</b>	<b>-</b>	<b>7,318,050,871</b>
<b>Vlera neto kontabël</b>								
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,567,449,475</b>	<b>1,724,073,025</b>	<b>5,722,000,708</b>	<b>806,527,581</b>	<b>201,840,441</b>	<b>47,239,910</b>	<b>423,606,184</b>	<b>10,492,737,324</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,567,449,475</b>	<b>1,644,571,400</b>	<b>5,437,898,998</b>	<b>1,457,585,061</b>	<b>244,644,635</b>	<b>53,730,950</b>	<b>969,356,228</b>	<b>11,375,236,747</b>

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, shoqëria nuk ka asnjë aktiv afatgjatë material të vënë si kolateral

**13. Aktive afatgjata jo materiale**

Aktivet afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	Programe dhe software	Në proces	Total
<b>Me kosto</b>			
Gjendja më 1 janar 2019	90,858,826	134,569,965	225,428,791
Shtesa	1,548,000	2,282,333	3,830,333
Pakësime	-	(657,474)	(657,474)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>92,406,826</b>	<b>136,194,824</b>	<b>228,601,650</b>
Shtesa	6,165,450	20,705,702	26,871,152
Pakësime	-	(52,935,113)	(52,935,113)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>98,572,276</b>	<b>103,965,413</b>	<b>202,537,689</b>
<b>Amortizimi</b>			
Gjendja më 1 janar 2019	45,196,514	-	45,196,514
Amortizimi i vitit	9,726,021	-	9,726,021
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>54,922,535</b>	<b>-</b>	<b>54,922,535</b>
Amortizimi i vitit	10,520,059	-	10,520,059
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>65,442,594</b>	<b>-</b>	<b>65,442,594</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2019</b>	<b>37,484,291</b>	<b>136,194,824</b>	<b>173,679,115</b>
<b>Gjendja neto më 31 dhjetor 2020</b>	<b>33,129,682</b>	<b>103,965,413</b>	<b>137,095,095</b>

**14. Aktive të tjera dhe Huadhënie afatgjata**

Aktivet e tjera afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Huadhënia në valutë ndaj PIU-të për investime në terminale	120,298,752	118,421,819
Hua dhënë palëve të treta	50,000,000	-
	<b>170,298,752</b>	<b>118,421,819</b>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***15. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme tregtare	85,334,770	36,217,360
Furnitorë për fatura të pambërritura	15,415,190	27,018,474
	<u><b>100,749,960</b></u>	<u><b>63,235,834</b></u>

**16. Detyrime të tjera**

Detyrimet e tjera të kompanisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vijojnë si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga të pagueshme	33,504,765	-
Detyrime për dividend	12,253,020	-
Detyrime për projekte	-	15,250,000
Të ardhura të shtyra	1,517,597	40,269,628
Detyrime të tjera	15,863,578	12,042,100
	<u><b>63,138,960</b></u>	<u><b>67,561,728</b></u>

**17. Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin dhe tatimi i parapaguar mbi fitimin më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi	28,747,746	(26,409,421)
	<u><b>28,747,746</b></u>	<u><b>(26,409,421)</b></u>

**18. Detyrime tatimore**

Detyrimet e tjera tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vijojnë si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	13,793,144	11,156,075
Detyrime për tatim page	11,194,963	3,467,202
Detyrime për tatim në burim	169,285	59,465
	<u><b>25,157,392</b></u>	<u><b>14,682,742</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***19. Provizione**

Shoqëria është e përfshirë në disa çështje gjyqësore me palë të ndryshme si e paditur dhe ka krijuar provizione gjatë vitit në vlerën 6,546,786 Lekë. (2019: 16,698,814 lekë). Balanca e provizioneve për vitin 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Gjendje në 1 janar	112,785,545	127,228,307
Paguar gjatë vitit	(7,612,766)	(31,141,576)
Provizione të krijuara gjatë vitit	6,546,786	16,698,814
	<u><b>111,719,565</b></u>	<u><b>112,785,545</b></u>

**20. Pjesa afatshkurter dhe afatgjate e huave që mbartin interesa**

Huatë që mbartin interesa përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua e Shoqatës së Zhvillimit Ndërkombëtar (IDA)	1,211,788,269	1,325,045,680
Hua e Bankës Europiane të Investimeve (BEI)-1	395,839,998	523,611,008
Hua e Bankës Europiane të Investimeve (BEI)-2	1,484,400,000	1,461,240,000
Hua nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)	240,449,408	394,496,411
Interes i përllogaritur	7,157,561	10,103,134
	<u><b>3,339,635,236</b></u>	<u><b>3,714,496,233</b></u>

Përveç huasë me BERZH e cila është kontraktuar direkt me APD dhe ka si garantues Qeverinë Shqiptare, huatë e tjera me IDA dhe BEI 1 janë marrë nëpërmjet kontratave të nën-huave me Ministrinë e Financave, e cila është huamarrësja e parë e huave nga këto institucione kreditimi.

Huaja e kontraktuar me IDA fillimisht në 9 Qershor 1998 ishte prej 12,600,000 SDR. Shuma e huasë është ndryshuar sipas dokumentit datë 30/10/2004 "Ndryshim në marrëveshjen e nënhuasë të datës 28.12.2002, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Autoritetit Portual Durrës për projektin e Portit Durrës, financuar nga IDA me kredinë nr.3068 ALB" dhe deri më 31 Dhjetor 2018 është disbursuar shuma prej 12,045,858 SDR. Ripagesat kanë filluar më 15 tetor 2008 dhe do të vazhdojnë deri më 15 prill 2038. Gjatë vitit 2020, është paguar 476,762.9 SDR (2019; 476,762.9SDR). Huaja mbart një normë interesi fikse prej 0.75% në vit.

Huaja nga BERZH prej 14,000,000 EUR është kontraktuar gjatë vitit 2008. Deri më 31 dhjetor 2018, është disbursuar shuma prej 12,465,685.64 EUR. Në 22 mars 2018 pjesa mbetur pa disbursuar prej 1,534,314.36 EUR, është anuluar. Mbi shumën e padisbursuar është paguar komision angazhimi prej 0.5% në vit. Ripagesat kanë filluar në 6 Tetor 2010 dhe do të vazhdojnë deri më 6 prill 2022. Huaja mbart një normë interesi EURIBOR 6 mujor plus 1% në vit. Gjatë vitit 2020 është paguar 1,295,873.84 EUR (2019 është paguar 1,295,873.84 EUR).

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***20. Pjesa afatshkurter dhe afatgjate e huave që mbartin interesa (vazhdim)**

Huaja 1 nga BEI prej 17,000,000 EUR është marrë më 11 Tetor 2002. Deri më 31 dhjetor 2018, është disbursuar shuma prej 16,000,000 EUR. Në 8 Korrik 2016 shuma prej 1 milion Euro është anuluar. Ripagesat kanë filluar me 15 Korrik 2008 dhe do të vazhdojnë deri më 10 Prill 2023. Gjatë vitit 2020 është paguar 1,066,666.66 EUR (2019; 1,266,666.66 EUR). Huaja mbart një normë interesi EURIBOR plus 2.5% në vit.

Huaja 2 nga BEI prej 18,000,000 EUR është marrë gjatë vitit 2008. Deri më 31 dhjetor 2018, është disbursuar shuma prej 12,000,000 EUR. Huaja do të disbursohet deri në gjashtë kështe prej 3,000,000 EUR secili dhe kushtet e ripagesave që përfshire interesin, do të përcaktohen nga EIB mbas disbursimit të çdo kësti.

Nën termat e huave me BERZH dhe BEI, Shoqëria nuk mund të shpërndajë dividend më shumë se 20% të fitimit vjetor. Kostoja totale për ndërtimin e një terminali të ri për pasagjerët ka shkuar 40,000,000 EUR, e cila është financuar nga burimet e mëposhtme:

<b>Burimi financues</b>	<b>Vlera në EUR</b>
Republika e Shqipërisë	5,800,000
Fonde nga Komuniteti European	2,200,000
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim	14,000,000
Banka Europiane e Investimeve	18,000,000
<b>Totali</b>	<b>40,000,000</b>

Huatë janë të garantuara nga Qeveria e Shqipërisë, dhe janë të ripagueshme si më poshtë:

	<b>IDA</b>	<b>BEI-Huaja 1</b>	<b>BEI-Huaja 2</b>	<b>BERZH</b>	<b>Totali</b>
<b>2020</b>	në SDR	në EUR	në EUR	në EUR	në Lekë ekuivalent
E pagueshme brenda një viti	476,763	1,066,667	1,123,039	1,295,874	500,411,270
E pagueshme në vitin e dytë	476,763	1,066,667	1,123,039	647,937	420,261,483
E pagueshme në vitin e tretë	476,763	1,066,667	1,123,039	-	340,111,676
E pagueshme në vitin e katërt	476,763	-	1,123,039	-	208,164,968
E pagueshme në vitin e pestë	476,763	-	1,123,039	-	208,164,968
E pagueshme pas 5 vitesh	5,959,536	-	6,384,805	-	1,655,363,310
<b>Totali 1</b>	<b>8,343,351</b>	<b>3,200,001</b>	<b>12,000,000</b>	<b>1,943,811</b>	<b>3,332,477,675</b>
Interesi i përlogaritur					7,157,561
<b>TOTAL</b>					<b>3,339,635,236</b>
Të pagueshme brenda një viti					500,411,270
Kësti afatgjatë					2,839,223,966

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***20. Pjesa afatshkurter dhe afatgjate e huave që mbartin interesa (vazhdim)**

	IDA	BEI-Huaja 1	BEI-Huaja 2	BERZH	Totali
2019	në SDR	në EUR	në EUR	në EUR	në Lekë ekuivalent
E pagueshme brenda një viti	476,763	1,266,667	1,123,039	1,295,874	520,417,148
E pagueshme në vitin e dytë	476,763	1,266,667	1,123,039	1,295,874	520,417,148
E pagueshme në vitin e tretë	476,763	1,266,667	1,123,039	647,937	441,517,879
E pagueshme në vitin e katërt	476,763	500,000	1,123,039	-	269,261,549
E pagueshme në vitin e pestë	476,763	-	1,123,039	-	208,376,549
E pagueshme pas 5 vitesh	6,436,299	-	6,384,805	-	1,744,402,826
<b>Totali 1</b>	<b>8,820,114</b>	<b>4,300,001</b>	<b>12,000,000</b>	<b>3,239,685</b>	<b>3,704,393,099</b>
Interesi i përlogaritur					10,103,134
<b>TOTAL</b>					<b>3,714,496,233</b>
Të pagueshme brenda një viti					520,417,148
Kësti afatgjatë					3,194,079,085

**21. Detyrime te tjera**

Detyrime te tjera përbëhen garancitë e mbajtura për huatë si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Garanci e mbajtur për huanë e IDA dhe BERZH	312,870,089	311,707,101
	<b>312,870,089</b>	<b>311,707,101</b>

**22. Kapitali***Kapitali aksioner*

Shoqëria u themelua dhe u regjistrua si Shoqëri Aksionere më 4 Dhjetor 1998 me një kapital aksioner prej 5,418,000,000 LEKE, i ndarë në 5418000 aksione me vlerë 1000 Lekë secili. Në 16 Tetor 2001, kapitali aksioner i Shoqërisë u rrit me 52,000,000 LEKE, i ndarë në 52000 aksione me vlerë 1000 LEKE secili. Rritja ishte në formën e kontributit në natyrë si ndërtesa, makineri dhe pajisje me një vlerë prej 52,879,190 Leke. Deri në 30 Qershor 2006 aksioneri i Shoqërisë ishte shteti me administrator Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës së Shqipërisë. Që prej asaj date Shoqëria zotërohet nga shteti me administrator Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë. Kapitali aksioner i regjistruar është 5,470,000,000 Lekë, i ndarë në 5,470,000 aksione me vlerë nominale 1,000 Lekë secili.

*Rezerva ligjore*

Rezerva ligjore është krijuar në përputhje me ligjin shqiptar “Për shoqëritë tregtare” që i kërkon Shoqërive të krijojnë një rezervë deri në 10% të kapitalit të regjistruar duke ngarkuar 5% të fitimit neto të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës. Për vitin 2020 kjo rezervë është shtuar me një vlerë prej 12,253,020 Lekë sipas Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 15 datë 30.07.2020 “Për Miratimin e Pasqyrave Financiare dhe Shpërndarjes së Fitimit Neto nga Rezultatit Ushtrimor i Vitit 2019”. Gjendja më 31 Dhjetor 2020 e rezervës ligjore është 331,716,751 Lekë (2019: 319,463,730 Lekë).

*(Vlerat janë në Lek)*

**22. Kapitali (vazhdim)**

*Ndarja e dividendit*

Gjatë vitit 2020 shoqëria ka vendosur të shpërndajë dividend në masën 5% të fitim neto të vitit 2019 me një vlerë 12,253,021 Lekë sipas Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 15 datë 30.07.2020 “Për Miratimin e Pasqyrave Financiare dhe Shpërndarjes së Fitimit Neto nga Rezultatit Ushtrimor i Vitit 2019”.

*Rezerva të tjera*

Rezerva të tjera për vitin 2020 është shtuar me një vlerë 220,554,357 Lekë sipas Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 15 datë 30.07.2020 “Për Miratimin e Pasqyrave Financiare dhe Shpërndarjes së Fitimit Neto nga Rezultatit Ushtrimor i Vitit 2019”. Në fund të këtij viti ka patur edhe një rritje në vlerën e kuotave të zotëruara nga Autoriteti Portual Durrës në fondin e investimit CREDINS INVEST, në shumën 14,194,206 lekë.

Gjendja më 31 dhjetor 2020 e Rezerva të tjera është 4,059,232,648 Lekë (2019: 3,824,484,085 Lekë).

**23. Grante qeveritare të shtyra**

Grante qeveritare të shtyra të kompanisë më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 vijnë si mëposhtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Grant qeveritar nga SHBA	12,078,514	15,098,142
Grant nga EU	365,213,348	384,435,104
Aktive të marra në dorezim	784,171,728	12,632,498
	<u><b>1,161,463,590</b></u>	<u><b>412,165,744</b></u>

**24. Të ardhura nga shërbimet**

Të ardhurat nga shërbimet kategorizohen sipas terminaleve: terminali i mallrave gjenerale, terminali i mallrave rifuzo, terminali i kontenierëve, terminali i trageteve dhe administrata dhe detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Terminali i mallrave gjenerale	346,682,402	356,998,442
Terminali i mallrave rifuzo (+ konçesion)	236,530,920	229,126,410
Terminali i kontenierëve (+ konçesion)	1,156,083,393	439,830,183
Terminali i trageteve (+ konçesion)	421,671,899	653,779,423
Administrata	97,599,142	115,395,662
	<u><b>2,258,567,756</b></u>	<u><b>1,795,130,120</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës**

**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

*(Vlerat janë në Lek)*

**24. Të ardhura nga shërbimet (vazhdim)**

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Qarkullimi tatueshem sipas FDP	2,291,865,523
Sipas kontabilitetit	2,417,997,569
<b>Diferenca</b>	<b>(126,132,046)</b>
Të ardhura nga subvencionet	123,460,722
Zbriten te ardhurat nga kamatvonesat	2,671,324
<b>Totali axhustimeve</b>	<b>126,132,046</b>
<b>Diferenca</b>	<b>-</b>

**25. Të ardhura të tjera**

Të ardhura të tjera përbëhen nga:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Grante qeveritare	123,460,722	37,541,059
Gjoha dhe penalitete	124,605	2,971,665
Të tjera	35,844,486	4,367,698
	<b>159,429,813</b>	<b>44,880,422</b>

**26. Furnizime dhe shërbime**

Shpenzimet për furnizime dhe shërbime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Furnizime per materiale	200,405,576	58,125,909
Mirembajtje dhe riparime	102,921,040	87,862,393
Furnizime per energji	113,506,419	115,201,745
Te tjera	6,666,140	7,776,154
	<b>423,499,175</b>	<b>268,966,201</b>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***27. Shpenzime personeli**

Shpenzimet për paga dhe kontribute për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</b>
Shpenzime paga	573,276,126	481,700,071
Shpenzime për sigurime shoqërore	93,405,156	78,859,085
Shpërblime	43,302,720	34,247,880
Honorare	5,210,864	5,218,591
Shpenzime të tjera për personelin	2,012,860	1,490,720
	<b>717,207,726</b>	<b>601,516,347</b>

Numri mesatar i personelit gjatë 2020 sipas funksioneve është si vijon:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Drejtues	47
Specialist (Niveli I, II, III, IV)	139
Staf operativ	355
	<b>541</b>

**28. Shpenzimet të tjera operative**

Shpenzimet e tjera operative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Siguracione	20,052,817	21,815,033
Publicitet dhe reklama	1,042,914	1,482,347
Qira	4,873,312	-
Shpenzime udhëtimi dhe akomodimi	613,869	5,824,257
Shpenzime auditimi	2,300,000	-
Gjoha e demshperblime	10,951,117	8,857,193
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,528,011	1,556,004
Shërbime bankare	929,472	515,826
Shpenzime te ndryshme per projektet	52,752,004	7,789,616
Vlera kontabël e aktiveve të shitura/nxjrrje jashte perdorimi	-	56,408,563
Të tjera	39,667,523	8,145,793
	<u><b>134,711,039</b></u>	<u><b>112,394,632</b></u>

**29. Shpenzime zhvlerësimi dhe provizioni**

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe provizioni për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarëve	3,379,527	-
Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim	106,047,438	-
Lëvizjet në provizione për debitorë të tjerë	13,970,865	-
Provizione të tjera krijuara gjatë vitit	6,546,786	16,698,814
Lëvizjet në provizione për zhvlerësimin e AQ	1,070,638	-
	<u><b>131,015,254</b></u>	<u><b>16,698,814</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës**

**Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

(Vlerat janë në Lek)

**30. Te ardhura (shpenzime) interesi (neto)**

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit (net) për vitin 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për interesa	32,003,286	42,025,507
Të ardhura nga interesat	(1,485)	(184,931)
Interesa për depozitat	(3,343,359)	(7,832,996)
	<u><b>28,658,442</b></u>	<u><b>34,007,580</b></u>

**31. Fitime (humbje) nga kursi i këmbimit (neto)**

Fitime (humbjet) nga kursi i këmbimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Humbje nga këmbimet valutore	58,143,644	(23,674,020)
Të ardhura nga këmbimet valutore	(74,014,467)	38,035,302
	<u><b>(15,870,823)</b></u>	<u><b>14,361,282</b></u>

**32. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Përlllogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	<b>431,457,787</b>	<b>293,233,134</b>
<b>Total shpenzime të panjohura</b>	<b>195,761,290</b>	<b>28,177,727</b>
Zhvleresime aktive afatgjata jomateriale	52,752,004	-
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	10,951,117	8,857,193
Shpenzime zhvlerësimi (provizione)	131,015,254	16,698,814
Shpenzime të tjera të panjohura	1,042,915	2,621,720
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<b>627,219,077</b>	<b>321,410,861</b>
Te ardhura te patatueshme	-	(259,295)
<b>Fitimi i tatueshem</b>	<b>627,219,077</b>	<b>321,151,566</b>
<i>Tatim fitimi @15%</i>	94,082,862	48,172,735
	<u><b>337,374,925</b></u>	<u><b>245,060,399</b></u>

**Autoriteti Portual Durrës****Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***32. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)**

Gjatë vitit 2020 Shoqëria ka bërë parapagime të tatim fitimit në shumën 38,925,695 Lekë (2019: 98,118,934 Lek), bazuar në parashikimin e organeve tatimore për detyrimet e taksave. Detyrimi në fund të vitit është 28,747,746 Lekë (2019: Parapagimi 26,409,421 Lekë).

Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Norma efektive	Lek	Norma efektive	Lek
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>431,457,787</b>		<b>293,233,134</b>
Tatimi fillestar	15.00%	64,718,668	15.00%	43,984,970
Efekt i tatimor i shpenzimeve që nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore	6.81%	29,364,194	1.44%	4,226,659
Efekt i diferencave në të ardhura të patatueshme	0.00%	-	-0.013%	(38,894)
<b>Tatim fitimi</b>	<b>21.81%</b>	<b>94,082,862</b>	<b>16.43%</b>	<b>48,172,735</b>

**33. Kushtëzime financiare**

Marveshja e kredisë e BERZH datë 16 Maj 2007 përfshin disa kondita financiare për APD në seksionin 4.03, të cilat kërkojnë që në cdo datë të pagimit të principalit APD duhet të mbajë në një nivel të caktuar raportet e mëposhtme financiare:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Raporti:		
Fluksi i mjeteve monetare të gjeneruara nga aktiviteti operacional për periudhën 12 mujore përpara datës së pagimit të principalit, plus interesat e paguara gjatë kësaj periudhe minus fluksin e mjeteve monetare që është përdorur për blerjen e aktiveve afatgjata	0.59	0.79
/ Shumën e principalit dhe interesit për tu paguar në periudhën 12 mujore pas datës së pagimit të principalit		

**34. Angazhime dhe detyrimet e mundshme**

*Angazhime nga marrëveshjet e huave:*

	31 dhjetor 2020		31 dhjetor 2019	
	Valute (EUR)	Ekuivalent Leke	Valute (EUR)	Ekuivalent Leke
BEI Loan 2	12,000,000	1,484,400,000	12,000,000	1,461,240,000
<b>Totali</b>	<b>12,000,000</b>	<b>1,484,400,000</b>	<b>12,000,000</b>	<b>1,461,240,000</b>

**35. Transaksionet me palët e lidhura**

Aksionet e shoqërisë APD zotërohen 100% nga shteti, me administrator Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë. Nuk ka patur transaksione për shitjen ose blerjen e mallrave apo shërbimeve me palët e lidhura gjatë vitit 2020 dhe 2019.

***Pagesa e drejtuesve kryesorë***

Gjatë vitit 2020 APD ndryshoi strukturën organizative duke shkurtuar pozicionin e zv. Drejtorit të Përgjithshëm dhe shtuar pozicionin e Drejtorit të Divizionit. Pagesa e përgjithshme që është bërë për drejtuesit kryesorë për vitin 2020 paraqitet si vijon:

Për Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv 2,474,825 Lekë (2019; 2,658,219 Lekë); për tre Zv/Drejtorët e Përgjithshëm 3,507,909 Lekë (2019 dy Zv.drejtorë: 5,338,329 Lekë); për gjashtë Drejtorët e Divizioneve 5,128,933 Lekë (2019: 0 Lekë).

<b>Pozicioni</b>	<b>Paga Bruto</b>	<b>Shpërblim</b>	<b>Ndalesa</b>	<b>Përfitimi Neto</b>
Drejtor	2,917,200	236,500	678,875	2,474,825
Drejtor divizioni	5,470,915	949,600	1,291,582	5,128,933
Zv.drejtor	4,403,400	-	895,491	3,507,909
				<b>11,111,667</b>

***Pagesa e Këshillit Drejtues***

Pagesa e përgjithshme që është bërë për Këshillin Drejtues gjatë vitit 2020 është 3,610,684 Lekë (2019: 4,380,652 Lekë), e detajuar si më poshtë:

<b>Pozicioni</b>	<b>Honorari Bruto</b>	<b>Shpërblim</b>	<b>Ndalesa</b>	<b>Përfitimi Neto</b>
Anëtar	1,947,000	177,000	318,600	1,805,400
Anëtare	565,864	118,000	102,580	581,284
Kryetare	702,000	78,000	117,000	663,000
Zv.kryetar	594,000	66,000	99,000	561,000
				<b>3,610,684</b>

**36. Menaxhimi i riskut financiar**

**a) Faktorët e rrezikut financiar**

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të Shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

**36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**b) Përcaktimi i vlerës së drejtë**

Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv, ose mund të shlyhet një pasiv, midis palëve të vullnetëshme të mirë-informuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën. Vlerat reale janë të bazuara në supozime të Drejtimit sipas llojit të aktivitetit dhe pasivit.

**Instrumentat financiarë të njohura me vlerën e drejtë**

Aktivet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Kjo hierarki grupon aktivet financiare dhe detyrimet në tri nivele që janë të bazuara mbi rëndësinë e të dhënave hyrëse të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare.

Hierarkia sipas vlerës së drejtë është përcaktuar si më poshtë:

Niveli 1: çmimet e kuotuar (të pakorigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;

Niveli 2: të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të disponueshme për aktivet dhe detyrimet të observuar, direkt (psh çmimet) ose indirekt (të dhëna nga çmimet) dhe

Niveli 3: të dhëna mbi aktivet dhe detyrimet që nuk janë të bazuar në të dhëna të disponueshme nga observimi i tregut.

Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 shoqëria nuk ka instrumenta financiare të njohura me vlerë të drejtë.

**Instrumentat financiarë që nuk janë njohur me vlerë të drejtë**

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat e drejta të atyre aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në Pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën e drejtë të tyre (shumat në Lekë):

Aktivet	Vlera kontabël		Vlera e drejtë	
	2020	2019	2020	2019
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	1,142,700,223	1,311,170,872	1,142,700,223	1,311,170,872
Llogari të arkëtueshme,neto	470,001,379	444,864,319	470,001,379	444,864,319
<b>Totali i aktiveve</b>	<b>1,612,701,602</b>	<b>1,756,035,191</b>	<b>1,612,701,602</b>	<b>1,756,035,191</b>
<b>Detyrimet</b>				
Llogari të pagueshme	100,749,960	63,235,834	100,749,960	63,235,834
Detyrime të tjera	63,138,960	67,561,728	63,138,960	67,561,728
Huamarrjet	3,332,477,675	3,704,393,099	3,332,477,675	3,704,393,099
<b>Totali i detyrimeve</b>	<b>3,496,366,595</b>	<b>3,835,190,661</b>	<b>3,496,366,595</b>	<b>3,835,190,661</b>

**36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**c) Huatë dhe të arkëtueshme**

Huatë dhe të arkëtueshme janë të mbajtura me koston e amortizuar, minus provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre e drejtë përaftron me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturitetit të shkurtër.

**d) Aktive financiare të tjera**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare, që përfshin paranë dhe ekuivalentet e saj është konsideruar e përafërt me vlerën e saj përkatëse kontabël për shkak të maturimit të tyre prej më pak se 1 vit.

**e) Llogari të pagueshme dhe huamarrjet**

Vlera kontabël e llogarive të pagueshme dhe huave përaftron vlerën e drejtë të tyre për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

**f) Administrimi i rrezikut financiar**

Shoqëria është ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- risku i kredisë
- risku i likuiditetit
- risku i tregut

***Risku i kredisë***

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë vendosur për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që përballet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Instrumentet financiare kryesore të Shoqërisë konsistojnë në vlerat në arkë dhe në banka, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, huatë dhe detyrime të tjera.

Rreziku i mos - pagesës ekziston kur pala tjetër nuk mund të përmbushë detyrimet për pagesën e llogarive të arkëtueshme. Maksimumi i rrezikut të kredisë për instrumentet financiare jo-derivative është teorikisht i barabartë me vlerën e drejtë të të gjitha llogarive të arkëtueshme minus detyrimet kundrejt të njëjtit debitor kur kompensimi është i lejuar. Rreziku i kredisë i cili është identifikuar merret parasysh nëpërmjet zhvlerësimeve. Shoqëria nuk ka përqendrimin te konsiderueshem te riskut të kredisë për shkak të numrit të madh të klientëve me profileve të ndryshme në industri të ndryshme dhe rajone gjeografike te ndryshme. Shoqëria ka politika për të siguruar se shitjet e mallrave dhe shërbimeve janë bërë për klientët me një histori krediti të përshtatshme. Shoqëria ka politika që kufizojnë sasinë e ekspozimit të kredisë për cdo kundër parti.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj riskut të kredisë, është paraqitur nga vlera kontabël neto e çdo aktivi financiar në pasqyrën e gjendjes financiare dhe përmbledhen si më poshtë:

<b>Aktivitet financiar</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	1,142,700,223	1,311,170,872
Llogari të arkëtueshme, neto	470,001,379	444,864,319
<b>Totali</b>	<b>1,612,701,602</b>	<b>1,756,035,191</b>

Rreziku i kredisë për mjetet monetare në arkë dhe në bankë është konsideruar i papërfillshëm, pasi palët janë banka me reputacion me vlerësime të jashtëm të cilësisë të lartë të kredisë

**36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**f) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

***Risku i Likuiditetit***

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Shoqëria i përmbush nevojat për mjete monetare, kryesisht nga të ardhurat që rrjedhin nga aktiviteti i saj.

Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Tabelat e mëposhtme (shumat në Lek) përfaqësojnë maturimin kontraktual të mbetur të detyrimeve financiare të shoqërisë. Tabelat janë përgatitur në bazë të flukseve të mjeteve monetare të paskontuar të detyrimeve financiare.

<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>Afatshkurtra</b>	<b>Afatgjata</b>	
	<b>1 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vjet</b>	<b>Më shumë se 5 vjet</b>
Huamarrjet	500,411,270	1,176,703,094	1,655,363,311
Llogari të pagueshme	100,749,960	-	-
Detyrime të tjera	63,138,960	-	-
<b>Total</b>	<b>664,300,190</b>	<b>1,176,703,094</b>	<b>1,655,363,311</b>

<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>Afatshkurtra</b>	<b>Afatgjata</b>	
	<b>1 deri në 12 muaj</b>	<b>1 deri në 5 vjet</b>	<b>Më shumë se 5 vjet</b>
Huamarrjet	520,417,148	1,439,573,125	1,744,402,826
Llogari të pagueshme	63,235,834	-	-
Detyrime të tjera	67,561,728	-	-
<b>Total</b>	<b>651,214,710</b>	<b>1,439,573,125</b>	<b>1,744,402,826</b>

Shumat e mësipërme pasqyrojnë flukset kontraktuale të pa skontuara të cilat mund të ndryshojnë për vlerat kontabël të shpenzimeve në pasqyrën e pozicionit financiar.

***Risku i tregut***

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh:

- risku i normës së interesit,
- risku i kursit të këmbimit,
- risku i çmimit të mallrave dhe
- risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

f) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

**Risku i tregut (vazhdim)**

*Risku i normave të interesit*

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Tabela e mëposhtme përmbledh ekspozimin e Shoqërisë ndaj rrishtit të normës së interesit:

<b>Aktivet financiare</b>	<b>2020</b>	<b>2019</b>
<i>Që nuk mbartin interes:</i>		
Llogari të arketueshme, neto	470,001,379	444,864,319
<i>Me normë fikse interesi:</i>		
Mjete monetare	1,142,700,223	1,311,170,872
<b>Totali</b>	<b>1,612,701,602</b>	<b>1,756,035,191</b>
<b>Detyrimet financiare</b>		
<i>Që nuk mbartin interes:</i>		
Llogari të pagueshme	100,749,960	63,235,834
Detyrime të tjera	63,138,960	67,561,728
<i>Me normë fikse interesi:</i>		
Huatë	2,696,188,150	2,786,285,627
<i>Me normë të ndryshueshme interesi:</i>		
Huatë	636,289,525	918,107,472
<b>Totali</b>	<b>3,496,366,595</b>	<b>3,835,190,661</b>

*Analiza e ndjeshmërisë për normën e interesit:*

	<b>2020</b>	<i>Vlera Neto</i>	<b>2%</b>	<b>-2%</b>
<b>Me normë të ndryshueshme interesi</b>	<b>636,289,525</b>	<b>12,725,791</b>	<b>(12,725,791)</b>	
	<b>2019</b>	<i>Vlera Neto</i>	<b>2%</b>	<b>-2%</b>
<b>Me normë të ndryshueshme interesi</b>	<b>918,107,472</b>	<b>18,362,149</b>	<b>(18,362,149)</b>	

36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

f) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

*Risku i monedhës*

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Shoqëria ekspozohet ndaj rrezikut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me huatë në USD, EUR, SDR. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje derivative për kontrata të ardhshme shkëmbimi më 31 Dhjetor 2020 dhe 2019.

Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Më 31 Dhjetor 2020				
Aktivët financiarë	EURO	USD	SDR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	880,958,622	43,402,095	-	924,360,717
Llogari të arkëtueshme, neto	113,114,744	-	-	113,114,744
<b>Totali</b>	<b>994,073,366</b>	<b>43,402,095</b>	<b>-</b>	<b>1,037,475,461</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogari të pagueshme	(14,855,238)	-	-	(14,855,238)
Huatë që mbartin interes	(2,120,689,525)	-	(1,211,788,150)	(3,332,477,675)
<b>Totali</b>	<b>(2,135,544,763)</b>	<b>-</b>	<b>(1,211,788,150)</b>	<b>(3,347,332,913)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(1,141,471,397)</b>	<b>43,402,095</b>	<b>(1,211,788,150)</b>	<b>(2,309,857,452)</b>

Më 31 Dhjetor 2019				
Aktivët financiarë	EURO	USD	SDR	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,028,807,350	43,375,095	-	1,072,182,445
Llogari të arkëtueshme, neto	115,799,142	-	-	115,799,142
<b>Totali</b>	<b>1,144,606,492</b>	<b>43,375,095</b>	<b>-</b>	<b>1,187,981,587</b>
<b>Detyrimet financiare</b>				
Llogari të pagueshme	(5,654)	-	-	(5,654)
Huatë që mbartin interes	(2,379,347,472)	-	(1,325,045,627)	(3,704,393,099)
<b>Totali</b>	<b>(2,379,353,126)</b>	<b>-</b>	<b>(1,325,045,627)</b>	<b>(3,704,398,753)</b>
<b>Pozicioni neto</b>	<b>(1,234,746,634)</b>	<b>43,375,095</b>	<b>(1,325,045,627)</b>	<b>(2,516,417,166)</b>

Tabela e mëposhtme përfaqëson ndjeshmërinë e Shoqërisë në rastin e një forcimi prej 10% të Lekut ndaj monedhave të huaja. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm njësitë monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe në rast të një ndryshimi prej 10% në kursin e këmbimit një korrigjim duhet të kryhet në vlerën e tyre. Shuma pozitive/negative tregon rritje/ulje në fitim apo kapital si rrjedhojë e forcimit/dobësimin të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja për +/- 10%.

*Analiza e ndjeshmërisë për ndryshimin e monedhave*

2020	Vlera neto	10%	-10%
<b>Fitimi ose Humbja</b>	<b>(2,309,857,528)</b>	<b>(230,985,753)</b>	<b>230,985,753</b>
<b>2019</b>	<b>Vlera neto</b>	<b>10%</b>	<b>-10%</b>
<b>Fitimi ose Humbja</b>	<b>(2,516,417,212)</b>	<b>(251,641,721)</b>	<b>251,641,721</b>

**36. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)**

**f) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

Objektivat e Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit janë për të ruajtur aftësinë e tij për të vazhduar në vijimësi, në mënyrë që të sigurojë kthimin për aksionerët dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe për të mbajtur një strukturë optimale të kapitalit për të ulur kështu koston e kapitalit.

*Raporti i Borxhit*

Struktura e kapitalit të shoqërise përbëhet nga detyrimet, të cilat përfshijnë huatë që mbartin interes, paraja dhe ekuivalentet e saj dhe kapitalin, i cili përbëhet nga kapitali aksionar, rezervat dhe fitimet e pashpërndara. Drejtimi shqyrton strukturën e kapitalit në bazë vjetore, si një lidhje midis detyrimeve të huave neto dhe totalit të kapitalit. Detyrimet e huave neto janë llogaritur si total i detyrimeve për huatë zvogëluar me shumën e parave dhe ekuivalenteve të saj.

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Huatë	3,332,477,675	3,704,393,099
Kapitali aksionar	10,279,799,727	9,940,483,617
<b>Raporti i borxhit</b>	<b>0.32</b>	<b>0.37</b>

**g) Instrumentat financiar sipas kategorisë**

Vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërise të njohur në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar, për periudhat e raportuara, mund të kategorizohen si më poshtë:

<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>Aktivet financiare me kosto të amortizuar</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivet sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,142,700,223	1,142,700,223
Llogari të arkëtueshme, neto	470,001,379	470,001,379
<b>Total</b>	<b>1,612,701,602</b>	<b>1,612,701,602</b>
	<b>Detyrimet financiare me kosto të amortizuar</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet sipas Pasqyrës së pozicionit financiar</b>		
Llogari të pagueshme	100,749,960	100,749,960
Detyrime të tjera	63,138,960	63,138,960
Huatë	3,332,477,675	3,332,477,675
<b>Total</b>	<b>3,496,366,595</b>	<b>3,496,366,595</b>
	<b>Aktivet financiare me kosto të amortizuar</b>	<b>Totali</b>
<b>31 dhjetor 2019</b>		
<b>Aktivet sipas Pasqyrës së pozicionit financiar</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,311,170,872	1,311,170,872
Llogari të arkëtueshme, neto	444,864,319	444,864,319
<b>Total</b>	<b>1,756,035,191</b>	<b>1,756,035,191</b>
	<b>Detyrimet financiare me kosto të amortizuar</b>	<b>Totali</b>
<b>Detyrimet sipas Pasqyrës së pozicionit financiar</b>		
Llogari te pagueshme	63,235,834	63,235,834
Detyrime të tjera	67,561,728	67,561,728
Huatë	3,704,393,099	3,704,393,099
<b>Total</b>	<b>3,835,190,661</b>	<b>3,835,190,661</b>

*(Vlerat janë në Lek)*

**37. Angazhime dhe pasiguri**

*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

*Detyrimet tatimore*

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

**38. Ngjarje pas datës së raportimit finaciar**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.